

VENDIM
Nr. 288, datë 28.5.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SPOSTIM I LINJAVE 220 kV KOMAN–TIRANA 2, LINJA 110 kV LAÇ
2 – TIRANË DHE LINJA 220 kV FIER–RRASHBULL, SI RRJEDHOJË E
NDËRTIMIT TË SEGMENTIT TË RRUGËS THUMANË–KASHAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Spostim i linjave 220 kV Koman – Tiranë 2, linja 110 kV Laç 2–Tiranë dhe linja 220 kV Fier–Rrashbull, si rrjedhojë e ndërtimit të segmentit të rrugës Thumanë–Kashar”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 807 069.15 (tetëqind e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë pikë pesëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 807 069.15 (tetëqind e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë pikë pesëmbëdhjetë) lekësh përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë–Vorë, Drejtoria Vendore Krujë dhe Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nisin procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë të pasurive që shpronësuara, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë–Vorë, Drejtoria Vendore Krujë dhe Drejtoria Vendore Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “SPOSTIM I LINJAVE 220 kV KOMAN–TIRANA 2, LINJA 110 kV LAÇ 2 – TIRANË DHE LINJA 220 kV FIER–RRASHBULL, SË RRJEDHOJË E NDËRTIMIT TË SEGMENTIT TË RRUGËS THUMANË–KASHAR”

NR. rendor	NR. shtyllë	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	
	Linja 110 kV Laç 2 - Kashar													
1	133/1	Ramazan	Halit	Lushi	Kodër Thumanë	2182	229/10	arë	8499	6.00	362	2,172.00	2,172.00	
2		Edmond	Ramadan	Terolli	Kodër Thumanë	2182	229/21	arë	6000	12.00	362	4,344.00	4,344.00	
3		Edmond	Ramadan	Terolli	Kodër Thumanë	2182	229/22	arë	403	18.00	362	6,516.00	6,516.00	
4	134/1	Esat	Bajram	Kadiu	Kodër Thumanë	2182	228/5	arë	6000	36.00	362	13,032.00	13,032.00	
	Linja 220 kV Koman -Tirana 2													
5	198/1	Gjon	Zef	Laçi	Bilaj	1185	37/13	arë	21600	79.09	233	18,427.97	18,427.97	
6	198/2	Lirije	Nikoll	Seli	Bilaj	1185	44/11	arë	16701	69.00	233	16,077.00	16,077.00	
		Haxhi	Lilo											
		Lindita	Pashk	Gjokeja										
		Kastriot	Pashk	Seli										
		Haxhi	Lilo											
		Artan	Pashk	Seli										
7	199	Valbona	Pashk	Pula	Bilaj	1185	48/7	arë	23276	86.36	233	20,121.88	20,121.88	
		Vlash	Nue	Shota										
		Kol	Vlash	Skura										
		Mhill	Vlash	Skura										
		Manushe	Vlash	Troksi										
		Marte	Vlash	Troksi										
8	199/1	Pashke	Pjetër	Skura	Bilaj	1185	79/25	arë	3911	77.63	233	18,087.79	18,087.79	
		Agustin	Kol	Skura										
		Flora	Kolë	Dobrozi										
		Miranda	Kol	Rrodastani										
		Drane	Dod	Përleka										
		Eduart	Pashk	Përleka										
9	201	Ardjan	Pashk	Përleka	Bilaj	1185	79/16	arë	16241	42.25	233	9,844.25	9,844.25	
		Mirela	Pashk	Troksi										
		Mimoza	Pashk	Musteqja										
		Pal	Preng	Perleka										
		Tixhe	Shaban	Çaka										
		Mehmet	Qazim	Çaka										
11	226	Hurme	Qazim	Kurti	Fushë-Prezë	1669	152/35	arë	3490	76.28	448	34,173.44	34,173.44	
		Pranvera	Asllan	Ahmeti										
		Ismajl	Qazim	Ahmeti										
12	227	Valentina	Hysen	Emiri	Fushë-Prezë	1669	157/1	arë	9330	72.83	448	32,627.84	32,627.84	
		Mynevere	Ramadan	Hasanaj										
		Besnik	Reshat	Hasanaj										
		Shpetim	Alizot	Emiri										
		Naim	Gani	Muka										
13	228				Bërxull	1167	13/10	arë	2000	71.82	448	32,175.36	32,175.36	
14	229	Islam	Xhuver	Muka	Bërxull	1167	67/1	arë	2500	71.82	448	32,175.36	32,175.36	
15	229/1	Liman	Ramazan	Shera	Bërxull	1167	13/29	arë	3370	27.61	448	12,369.28	12,369.28	
Xhume		Haxh	Shera	Bërxull	1167	13/35	arë	1660	21.00	448	9,408.00	9,408.00		
Bedri		Bajram	Shera											
17	229/2	Ilir		Hoxha	Bërxull	1167	128/3	arë	2160	73.15	448	32,771.20	32,771.20	
18	230	Roland	Enver	Hysa	Bërxull	1167	133/7	arë	5100	34.28	448	15,357.44	15,357.44	
19		Roland	Enver	Hysa	Bërxull	1167	133/8	arë	4500	42.00	448	18,816.00	18,816.00	

20	230/1	Hysen		Allmeta	Berxull	1167	201/3	arë	8700	71.82	448	32,175.36	32,175.36	
21		Sali	Ismail	Haka	Berxull	1167	203/15	arë	1700	37.00	448	16,576.00	16,576.00	
22	232	Arjol	Arshin	Bici	Berxull	1167	480/27	arë	10000	76.28	448	34,173.44	34,173.44	
23	232/1	Abdulla	Muhamet	Shehi	Berxull	1167	543/1/2	arë	2000	69.00	448	30,912.00	30,912.00	
24	232/2	Hasan	Zenel	Dervishi	Berxull	1167	543/7	arë	2190	76.28	448	34,173.44	34,173.44	
25	233/1	Xhaferri		Kamberi	Berxull	1167	546/5	arë	3200	55.88	448	25,034.24	25,034.24	
Linja 220 kV Fier Rrashbull														
26	225	Denisa	Skender	Hoxhallari	Mbrostar	2636	119/7	arë	2144	55.50	269	14,929.50	14,929.50	
27		Xhevdet	Hodo	Allka	Mbrostar	2636	119/8	arë	2078	103.77	269	27,914.13	27,914.13	
		Selvi	Meleq	Allka										
28	226	Hekuran	Xhemal	Merka	Mbrostar	2636	118/32	arë	2306	20.00	269	5,380.00	5,380.00	
29		Pellumb	Hekuran	Muho	Mbrostar	2636	118/34	arë	2213	2.00	269	538.00	538.00	
		Vasilika	Reis	Muho										
30	228	Hurma	Ramis	Lamaj	Sheq i Madh	3981	12/8	arë	4459	158.72	269	42,695.68	42,695.68	
31	231	Çomo	Haredin	Bregu	Sheq i Madh	3981	38/10	arë	7064	126.77	269	34,101.13	34,101.13	
32		Fatbardha	Ramadan	Bregu	Sheq i Madh	3981	38/11	arë	7064	32.00	269	8,608.00	8,608.00	
33	232	Blerta	Barjam	Selaci	Sheq i Madh	3981	130/38	arë	5000	158.64	269	42,674.16	42,674.16	
34	233	Petrit	Selim	Sollaku	Sheq i Madh	3981	129/11	arë	6148	152.24	269	40,952.56	40,952.56	
35		Agim	Ilazi	Cako	Sheq i Madh	3981	129/12	arë	7555	6.60	269	1,775.40	1,775.40	
36	234	Nasi	Kristo	Divija	Sheq i Madh	3981	127/13	arë	1969	4.60	269	1,237.40	1,237.40	
37		Thoma	Nasi	Divija	Sheq i Madh	3981	127/14	arë	6993	154.10	269	41,452.90	41,452.90	
38	235	Eli	Todi	Perri	Sheq i Madh	3981	126/17	arë	3250	26.00	269	6,994.00	6,994.00	
39		Sokrat	Lili	Çobo	Sheq i Madh	3981	126/22	arë	1224	108.00	269	29,052.00	29,052.00	
VLERA TOTALE										2,443.32		807,069.15	807,069.15	